



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 52 datë 17.04.2026

P Ë R

MIRATIMIN E RISHIKIMIT TË KUSHTEVE GJATË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:
“STRUKTURË HOTELERIE DHE REZIDENCA ME SHËRBIME TURISTIKE 5-6 KATE,
ME TARRACË TË SHFRYTËZUESHME, 1 KAT NËNTOKË ME MUR RRETHUES DHE
PISHINË”, ME VENDNDODHJE NË RADHIMË, BASHKIA VLORË

Në mbështetje të neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit” i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues “Regina Group” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

V E N D O S I:

1. Miratimin e rishikimit të kushteve të lejes gjatë ndërtimit për objektin: “Strukturë hotelerie dhe rezidenca me shërbime turistike 5-6 kate, me tarracë të shfrytëzueshme, 1 kat nëntokë dhe mur rrethues dhe pishinë” ,me vendndodhje në Radhimë, Bashkia Vlorë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Regina Group” sh.p.k, miratuar me Vendimin Nr. 48, datë 01.08.2023, të KKT-së.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave si dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë bashkëlidhur Vendimit Nr. 48, datë 01.08.2023, zëvendësohen me Hartën e Planvendosjes së Strukturave si dhe Dokumentin e Rregullores së Veçantë bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyjnë në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDDI RAMA



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
BLENDI GONXHJA



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT



Nënshkruar më datë 19/06/2026